

ALBSIG INVEST



Albsig Invest sh.a.

Fondi i Investimit Albsig Standard

Fondi i Pensionit Privat Albsig

Fondi i Pensionit Privat Smart Pension



PASQYRA PËRMBLEDHËSE

Contents

1.	MESAZH NGA ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM.....	4
2.	SHOQËRIA ALBSIG INVEST SH.A.	6
2.1.	Struktura e aksionerëve të shoqërisë administruese.....	6
2.2.	Objektivat e shoqërisë administruese	6
2.3.	Misioni dhe vlerat bazë	6
2.4.	Këshilli i administrimit	7
2.5.	Kodi i etikës	8
2.6.	Transparenca.....	9
3.	PËRGJEGJËSIA SOCIALE	10
3.1.	Aktivitetet dhe trajnime.....	10
3.1.1.	"I Love My Business", 2.000 Persona në Trajnimin e Ermal Mamaqit, Pjesëmarrëse dhe Albsig Invest	10
3.1.2.	Albsig Invest - Udhëtim në Mal të Zi me Rastin e 8 Marsit	11
3.2.	Albsig Invest merr pjesë në panairin e punës në fakultetin ekonomik Panairi Karrierës në UMT. Me mbështetjen e Albsig Invest një hap më pranë suksesit profesional.	12
3.3.	Albsig Invest mbështet Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" me rastin e festës së 1 Qershorit.	13
3.4.	Apeli i Stafit të Albsig Invest në Ditën Botërore të Dhurimit të Gjakut "Të gjithë Ne, me aq sa kemi mundësi, të dhurojmë gjak të paktën një herë në vit, sepse me çdo dhurim tonin, Ne shpëtojmë jetë"	13
4.	ECURIA E BORXHIT QEVERTAR DHE E NORMAVE TË INTERESIT GJATË VITIT 2023.	15
4.1.	Menaxhimi dhe politikat e investimit	15
4.2.	Ligji i ri për fondet private të pensioneve dhe efektet që priten të japë në zhvillimin e tregut të pensioneve private.....	15
4.3.	Tregu i pensioneve private vullnetare vijoi rritjen edhe gjatë vitit 2023.....	16
4.4.	Risitë e pritshme në tregun e fondeve të pensioneve për periudhën në vazhdim.	17
4.5.	Pritshmëritë për vitin 2024.....	18
5.	ECURIA E FONDIT TË INVESTIMIT "ALBSIG STANDARD"	18
5.1.	Objektivat dhe politika e investimit.....	19
5.1.1.	Profili i riskut dhe përfitimit	19
5.1.2.	Komisionet/tarifat e Fondit	20
5.1.3.	Komisione dhe tarifa të tjera të vazhdueshme	20
5.1.4.	Komisionet/tarifat të tjera të mbajtura nga Fondi.....	20
5.1.5.	Norma Neto e Kthimit për "Albsig Standard" 2021-2023	21
6.	ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT ALBSIG	22
6.1.	Politika e Investimit	22
6.1.1.	Elementet kryesore të politikës së investimit:.....	22
6.1.2.	Profili i riskut dhe përfitimit	22
6.1.3.	Komisionet/tarifat e Fondit	22
6.1.4.	Norma Neto e Kthimit për "Albsig Pension" 2021-2023	23
7.	ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT SMART PENSION.....	24
7.1.	Politika e Investimit	24
7.1.1.	Elementet kryesore të politikës së investimit:.....	24
7.1.2.	Profili i riskut dhe përfitimit	24



RAPORTI VJETOR 2023

7.1.3.	Komisionet/tarifat e Fondit	24
7.1.4.	Norma Neto e Kthimit për “Smart Pension” deri më	25
8.	PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	26
8.1.	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	29
8.2.	PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	30
8.3.	PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	31
8.4.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	32
9.	ALBSIG STANDARD	33
9.1.	RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	34
9.2.	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	37
9.3.	PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	38
9.4.	PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	39
9.5.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO	40
10.	ALBSIG PENSION	41
10.1.	RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	42
10.2.	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	45
10.3.	PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	46
10.4.	PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	47
10.5.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO	48
11.	SMART PENSION	49
11.1.	RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	50
11.2.	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	53
11.3.	PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	54
11.4.	PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	55



1. MESAZH NGA ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM

Të nderuar anëtarë dhe investitorë,

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të përzemërt për ju, anëtarët dhe investitorët tanë të çmuar, për mbështetjen dhe besimin tuaj të palëkundur në vizionin tonë. Së bashku, ne kemi ndërtuar një themel të fortë për sukses dhe jam i bindur se do të vazhdojmë të arrijmë lartësi të reja.

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj raportin vjetor për vitin financiar 2023, duke reflektuar një tjetër vit plot sfida dhe arritje.

Falë strategjisë sonë të investimeve të menduara dhe të disiplinuar, kemi arritur të ofrojmë një performancë të qëndrueshme dhe të sigurt për investimet tuaja. Tregjet e bonove dhe obligacioneve të shtetit shqiptar kanë qenë të qëndrueshme dhe kanë ofruar mundësi të mira për të maksimizuar kthimin për investitorët tanë.

Në vitin 2023, kemi përmirësuar edhe më tej menaxhimin e investimeve dhe transparencën në proceset tona, duke siguruar që çdo hap i marrë të jetë në përputhje me interesat tuaja afatgjata. Ne jemi të përkushtuar të ruajmë dhe të rrisim besimin tuaj në fondin tonë të pensioneve private dhe në investimet tona në bono dhe obligacione.

Një nga arritjet më të sukseshme gjatë vitit 2023 është padyshim hapja e fondit të ri të pensionit Smart Pension me depozitar Bankën Kombëtare Tregtare (BKT). Ky fond ishte një risi për tregun shqiptar për arsye se klientët mund të anëtarësohen Online nëpërmjet aplikacionit Smart që ofron Banka Kombëtare Tregtare.

Për të bërë një përmbledhje të ecurisë së Fondit të Pensionit Privat Albsig dhe Smart Pension deri në fund të vitit 2023 fondet numërojnë 4,391 plane pensioni. Ndërkohë që kthimi i vjetor i fondit të Pensionit Privat Albsig është +3.81%. Edhe pse Fondi i Pensionit Privat Smart Pension më 12.01.2024 plotësoi një vitë nga hapja, performoi me një normë kthimi +4.66%, duke rezultuar fondi me kthimin më të lartë në treg. Kjo është arritur falë mirëadministrimit të fondit dhe investimin në kohën e duhur.

Vlera neto e asetëve të fondeve të pensionit Albsig dhe Smart Pension në fund të muajit dhjetor 2023 arriti në 512 milion lekë, në rritje me 39% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Surprizë ka qenë padyshim edhe fondi i Investimit Albsig Standard, duke lënë një vitë të vështirë si ai i vitit 2022, arriti që të mbyllte vitin 2023 me një normë të kënaqëshme kthimi +8.02%. Vlen të theksohet se Vlera Neto e Asetëve (NAV) të fondit në mbyllje të vitit 2023 rezultoi më e lartë se ajo që ishte në fillim të këtij viti. Ky ishte dhe synimi i Shoqërisë Administruese për këtë fond në vitin 2023, duke parë situatën e krijuar një vit më parë dhe që rezultoi i suksesshëm.



Vlen të përmendet edhe miratimi i Ligjit të ri “Për fondet e pensionit privat” i cili hyri në fuqi në nëntor të 2023, ku shoqëria Administruese Albsig Invest ka asistuar në disa takime për miratimin e këtij ligji. Ligji i ri do të sjellë rritje të ndjeshme të incentivave fiskale për kontributet në fondet private të pensioneve.

Gjithashtu, me miratimin e projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, presim krijimin e fondeve të mbyllura të pensionit, që është një nga risitë e tjera që sjell ky ligj, që mund të jenë organizime të disa kompanive brenda një industrie të caktuar apo nën një bashkim punonjësish.

Së fundmi, ndërsa kalojmë në vitin e ardhshëm financiar, ne mbetemi të fokusuar në prioritetet tona strategjike. Qëllimi ynë është të konsolidojmë pozicionin tonë si lider tregu, të eksplorojmë mundësi të reja rritjeje dhe të rrisim vazhdimisht vlerën që u ofrojmë investitorëve tanë.

Mezi pres të ndaj me ju progresin dhe arritjet tona në vitin e ardhshëm. Faleminderit që jeni pjesë e pandashme e rrugëtimit tonë.

Me respekt,

Elton Korbi

Administrator i Përgjithshëm



2. SHOQËRIA ALBSIG INVEST SH.A.

Albsig Invest Sh.a., Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, është një shoqëri aksionare, me seli në Rrugën e Barrikadave, Albsig HQ, Kati 8, Tiranë. Albsig Invest Sh.a është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04.10.2019.

Albsig Invest Sh.a është licensuar Shoqëria Administruese me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nr. 210, datë 22.11.2019 “Për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit Privat në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit Privat dhe kryerjen e pagesave të pensionit, si dhe për administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive” (Licensa nr. 5, datë 22.11.2019 pa afat). Me vendimin e mësipërm AMF miratoi edhe Fondin e Pensionit Privat Albsig.

Me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nr. 255, datë 30.12.2019, u miratua Fondi i Investimit Albsig Standard.

Me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nr. 96, datë 28.04.2022., u miratua Fondi i Pensionit Privat “Smart Pension”.

Albsig Invest Sh.a mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2.1. Struktura e aksionerëve të shoqërisë administruese

Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Albsig Jetë Sh.a, i cili zotëron 100% të aksioneve.

Shoqëria Administruese mund të ketë nën administrim një ose disa fonde pensioni dhe një ose disa fonde investimi ne të njëjtën kohë.

Aktualisht Albsig Invest Sh.a ka nën administrim Fondin e Pensionit Privat Albsig, Fondin e Pensionit Privat “Smart Pension” dhe Fondin e Investimit Albsig Standard.

2.2. Objektivat e shoqërisë administruese

1. Mbledhja dhe investimi i fondeve të pensionit Privat si dhe kryerja e pagesave të pensionit;
2. Administrimi i fondeve të pensionit Privat dhe aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

2.3. Misioni dhe vlerat bazë

Misioni

Ofrimi i alternativave të përshtatshme për investitorët, ku çdokush të mund të gjejë mënyrën e duhur të investimit, duke u mbështetur tek:

- Informimi dhe edukimi i investitorëve mbi investimin në fonde pensioni dhe fonde investimi;
- Këshillimi i klientëve dhe orientimi i tyre drejt vendimmarrjes së duhur të investimit;



- Menaxhim cilësor të asetëve me qëllim kthime të kënaqshme nga investimi;
- Qeverisje të mirë të korporatës dhe transparencë maksimale për investitorët;
- Krijimi i alternativave të ndryshme investimi me qëllim që çdo investitor të mund të gjejë mundësinë e kërkuar të investimit.

Vizioni

Albsig Invest Sh.a synon dhënien e alternativave më të mira dhe të sigurta të investimit në tregun e kapitalit në Shqipëri.

2.4. Këshilli i administrimit

Këshilli i Administrimit është organi më i lartë i Shoqërisë Administruese i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administruese. Ai kujdeset që Shoqëria Administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat financiare, të investimit, Prospektin duke siguruar kështu administrimin e drejtë të Shoqërisë Administruese dhe përgjegjshmërinë kundrejt publikut për veprimet, angazhimin dhe rezultatet e saj. Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:

Z. Irfan LAMI: Kryetar i Këshillit të Administrimit

Z. Irfan Lami ka karrierë të gjatë në fushën financiare prej vitit 1995. Z. Lami ka eksperiencë disavjeçare



pranë ISSH në fushën e pensioneve, financës dhe auditimit. Ka eksperiencë mbi 18 vjeçare në menaxhimin financiar dhe drejtues të shoqërive të sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë. Prej vitit 2015 është Drejtor i Departamentit të Financës të Shoqërisë Albsig Sh.a. Z. Lami zotëron diplomë universitare e integruar e nivelit të dytë në Financë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, që nga viti 1995. Z. Lami ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit financiar dhe të riskut.

Z. Dritan KASTRATI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Dritan Kastriati ka një eksperiencë disavjeçare pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, si specialist i



trajtimit të dëmeve, sekretar i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve/Komisioneve dhe administrimit të praktikave të BSHS. Z. Kastriati prej vitit 2015 është pjesë e Albsig Sh.a si Drejtor i Departamentit të Dëmeve dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm. Z. Kastriati zotëron diplomë master në Administrim Publik nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Z. Kastriati ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit (publik dhe të shoqërive private), të sigurimeve, trajtimit të dëmeve dhe riskut.

Z. Elvis BEQIRI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Elvis Beqiri prej vitit 2017 është pjesë e shoqërisë Albsig Sh.a si Drejtor i Sigurimit të Përgjegjësive. Z. Beqiri ka një eksperiencë 14 vjeçare në fushën bankare në pozicione të ndryshme si Drejtor Departamenti, Drejtues Dege, etj. Z. Beqiri zotëron diplomë master në Administrim Biznesi (MBA) nga Universiteti Polis dhe IPAG Business School, Paris. Z. Beqiri ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit dhe financiare.



Z. Elton KORBI: Anëtar Ekzekutiv i Këshillit të Administrimit

Z. Elton Korbi është aktualisht Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Z. Korbi ka një eksperiencë mbi 13 vjeçare në sektorin bankar në banka tregtare dhe në Bankën e Shqipërisë, në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, kontabilitetit dhe analizës financiare. Z. Korbi zotëron diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë në Financë nga Universiteti i Tiranës si dhe diplomë master në Administrim Biznes (MBA) nga Universiteti Epoka. Z. Korbi nga viti 2015 është duke ndjekur studimet për marrjen e certifikatës ACCA (Association of Chartered Certified Accountants). Z. Korbi ka zhvilluar trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të riskut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit nga institucione prestigjioze si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Deutsche Bundesbank, BaFIN, Banque de France, etj.



Z. Admir RAMADANI: Anëtar Ekzekutiv i Këshillit të Administrimit

Z. Admir Ramadani është aktualisht Drejtor i Investimeve dhe Zëvendës Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Z. Ramadani ka një eksperiencë 13 vjeçare në sektorin bankar, nga të cilat 5 vjet në fushën e investimeve si dhe 8 vite në fushën e menaxhimit të risqeve. Z. Ramadani zotëron dy diploma në Ekonomiks dhe Matematikë nga Universiteti Amerikan në Bullgari. Z. Ramadani zotëron titullin CFA (Chartered Financial Analyst) që nga Tetor 2012.



2.5. Kodi i etikës

Kodi i Etikës është krijuar për të drejtuar etikën personale dhe profesionale të Shoqërisë Administruese. Ai përbëhet nga një set normash dhe rregullash që rregullojnë marrëdhëniet e përditshme të Shoqërisë Administruese. Ai është i zbatueshëm nga të gjithë punonjësit e Shoqërisë Administruese dhe pranë çdo filiali/dege/agjencie të saj. Veç kësaj, personat e tjerë që kryejnë shërbime për Shoqërinë Administruese i nënshtrohen Kodit të Etikës nëpërmjet kontratës apo marrëveshjes. Të gjithë kanë përgjegjësi për të



kontribuar dhe për të ndihmuar në mbajtjen dhe ruajtjen e reputacionit të mirë të Shoqërisë për ndershmëri, përkushtim, korrektesë, paanshmëri dhe integritet.

2.6. Transparenca

Transparenca është një nga parimet e shtuara që Albsig Invest e ka ndjekur që nga nisja e aktivitetit si një nga bazat më të rëndësishme për të krijuar urat lidhëse midis shoqërisë dhe klientëve, punonjësve, partnerëve si dhe regullatorëve të saj.

Shoqëria ka qenë dhe do të jetë gjithmonë transparente më të gjithë bashkëpunorët e saj në dhënien e informacioneve të plota dhe të sakta lidhur me produktet që ofron.

Shoqëria mban të informuar në mënyrë të vazhdueshme klientët e saj në lidhje me ecurinë e fondeve, tarifat që aplikohen si dhe rrisqet që mbart secili fond. Çdo ditë shoqëria përlllogarit dhe publikon çmimet dhe Vlerën Neto të Aseteve në faqen e saj të ëeb-it: www.albsiginvest.al.

Gjithashtu çdo klient pajiset me kredencialet e tij personale si Përdorues dhe Fjalëkalim, ku nëpërmjet tyre mund të monitoroj llogarinë e tij personale 24/7. Nëpërmjet platformës Selfcare klienti informohet për balancën e tij, trasaksionet, ecurinë e fondit si dhe mund të gjeneroj certifikatën e pronësisë së kuotave.

Të gjitha publikimet dhe raportet financiare dhe vjetore të Shoqërisë Administruese Albsig Invest dhe të fondeve që shoqëria ka nën administrim janë të disponueshme dhe mund të shfletohen elektronikisht në faqen zyrtare www.albsiginvest.al.



3. PËRGJEGJËSIA SOCIALE

3.1. Aktivitete dhe trajnime

3.1.1. "I Love My Business", 2.000 Persona në Trajnimin e Ermal Mamaqit, Pjesëmarrëse dhe Albsig Invest

Për shoqërinë Albsig Invest, është e rëndësishme që punonjësit e saj të jenë të pajisur me të gjitha njohuritë dhe aftësitë e nevojshme që u nevojiten për të kryer detyrat e tyre të përditshme në mënyrë efektive. Trajnimi i stafit është një metodë e cila i lejon Albsig Invest të investojnë në anëtarë të stafit që janë plot potencial dhe të aftë për t'u zhvilluar dhe bërë figura kyçe në biznes.

Është paraqitur komplet ndryshe, këtë herë në fokus ka qenë biznesi. Ndryshe nga cikli i trajnimeve të mëparshme, duket se pjesëmarrja ka qenë shumë më e madhe. Këtë radhë Ermal Mamaqi e çoi fokusin

e trajnimeve të tij tek biznesi dhe rritja në karrierë dhe kur bëhet fjalë për biznes, salla është tejmbushur.

Thuhet se rreth 2.000 persona u bënë pjesë e këtij trajnimi 2-ditor në Pallatin e Kongreseve.

Pjesëmarrësit i përjetuan të gjitha emocionet që ofroi ky trajnim. Ajo çfarë përfitohet mbi të gjitha është motivimi dhe njohuria për të rritur veten profesionalisht. "Fuqia e këtyre trajnimeve funksionon. Nëse do të kesh diçka që nuk e ke, duhet të bëhesh dikush që nuk je dhe që të bëhesh dikush që nuk je, duhet të shkosh në vende që nuk ke qenë, si këto trajnimet e çmendura

që njerëzit kërcejnë dhe hidhen, mendojnë, preken, qeshin dhe qajnë", u shpreh Mamaqi. Pjesë e trajnimit 2-ditor që nisi të premtën ishin grupmosha të ndryshme, njëkohësisht dhe nga biznese të ndryshme që kanë lënë gjurmë në zhvillimin e ekonomisë në vend. Në trajnim morën pjesë dhe pronar të bizneseve që treguan me detaje historikun e biznesit të tyre dhe dhanë mesazhe të rëndësishme për biznesin e ri.

Duke u ofruar anëtarëve të stafit mundësinë për të mësuar dhe për t'u rritur brenda kompanisë sonë, ne jo vetëm që po rrisim mundësinë e mbajtjes së këtyre punonjësve, por gjithashtu po krijoni një fuqi punëtore më të aftë që do të përfitojë nga biznesi dhe klienti në të ardhmen.

Stafi i Albsig Invest zhvendos shpesh nga rutina e përditshme për të përmirësuar dhe planifikuar vizionin dhe lidhjen e ekipit me trajnime praktike. Është vizioni i Albsig Invest që të ketë punonjës të motivuar, të cilët do t'ju shërbejnë klientëve në mënyrën më të mirë të mundshme.

"Fuqia e këtyre trajnimeve funksionon. Nëse do të kesh diçka që nuk e ke, duhet të bëhesh dikush që nuk je dhe që të bëhesh dikush që nuk je, duhet të shkosh në vende që nuk ke qenë, si këto trajnimet e çmendura që njerëzit kërcejnë dhe hidhen, mendojnë, preken, qeshin dhe qajnë."

- Ermal Mamaqi



Nëpërmjet këtyre trajnime, stafi ka mundësinë të lidhet me anëtarët e tjerë të ekipit me të cilët zakonisht nuk punon në baza ditore. Kjo për të treguar se ne jemi në gjendje të marrim vendime dhe të vendosim objektiva si ekip.

Vlera e këtyre trajnimeve të suksesshëm është se krijon situata të favorshme për të gjithë. Idetë kolektive të ekipit gjenerojnë efekte dhe rezultate pozitive afatgjata. Këto trajnime, gjithashtu bashkojnë ekipin në një vizion të përbashkët për të ardhmen e praktikës dhe një qëllimi për të ofruar kujdes të jashtëzakonshëm për klientët. Dhe për t'u kujtuar të gjithëve pse e duam atë që bëjmë.

3.1.2. Albsig Invest - Udhëtim në Mal të Zi me Rastin e 8 Marsit

Magjia që bartin udhëtimet është e pakrahasueshme, por kur udhëtimi bëhet me stafin e punës me të cilin kalon çdo ditë, është edhe më mbresëlënëse! Një arratisje nga e përditshmja ishte ajo që na kishte munguar ne në "Albsig Invest", për t'i dhënë ngjyra ditëve tona dhe për t'i bërë ato më të bukura, pasi energjia që merr nga udhëtimet është e patjetërsueshme dhe e pakrahasueshme. Budva ishte vendi që menduam të vizitonim, një nga vendbanimet më të vjetra në Malin e Zi, që spikat për historinë e pasur kulturore, turizmin, bregun kaltërosh dhe padyshim vendet e panumërta që mund të pushosh. Udhëtimi me autobus me të gjithë stafin e vajzave dhe grave të shoqërisë Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest, nisi në mëngjes herët. Udhëtimi shkoi shumë mirë. Grupe shoqërie të ndarë i shikoje duke kënduar në autobus. Pasi bëmë dy ndalime, mbërritëm në destinacionin e kërkuar.

Ne, në Albsig Invest besojmë se shërbimi i mirë vjen nga marrëdhëniet e forta që krijohen tek ekipi ynë, nga përkushtimi i çdo dite për të dhënë më të mirën dhe nga fryma e përfshirjes dhe solidaritetit me klientët. Që nga dita e parë e punës dhe gjatë gjithë viteve të përvojës, sfidojmë veten për të qenë gjithmonë në lartësinë e duhur, zhvillohemi për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të çdo klienti, sepse i konsiderojmë si partnerët tanë më të vlefshëm. Vlerat tona na bashkojnë e na bëjnë më të fortë për të përballuar çdo situatë.



3.2. Albsig Invest merr pjesë në panairin e punës në fakultetin ekonomik Panairi Karrierës në UMT. Me mbështetjen e Albsig Invest një hap më pranë suksesit profesional.



Në prag të mbylljes së një tjetër viti të suksesshëm akademik, Universiteti Metropolitan Tirana organizoi Panairin e Punës dhe Karrierës në muajin Maj. Jo vetëm studentët e UMT, por risia e këtij viti ishte edhe pjesëmarrja e hapur për studentë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në vend. Pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me tregun e punës për secilin nga fakultetet respektive, pasi të pranishëm në këtë panair ishin rreth 50 biznese më në zë të industrive të ndryshme si ajo e telekomunikacionit, bankare, teknologjike, tregut të sigurimeve, zhvillimet kompjuterike, kompani rekrutimesh por dhe agjenci dhe institucione qeveritare. Ky Panair i Punës dhe i Karrierës, këtë vit u organizua në shenjë të “Dual Studies”, nismës më të re të Universitetit Metropolitan Tirana për t’u ofruar studentëve mundësi punësimi gjatë periudhës së studimeve, sipas një procesi të rregulluar.

Stafi i fakultetit së bashku me studentët mirëpritën shumë prej kompanive në Tiranë, të cilat përmes prezantimeve, fletushkave e materialeve të tjera promovuese, njoftuan studentët për mundësitë e punës dhe pranuan CV-të e tyre për t’i shqyrtuar për punësim. Pjesë e këtij eventit-trajnimi ishte dhe Albsig Invest, pjesë e Kastrati Group.

Studentët patën mundësi të informoheshin për shumë mundësi praktike dhe punësimi të ofruara nga Albsig Invest. Albsig Invest vazhdon të jetë mbështetës i përhershëm i avancimit dhe ndërtimit të karrierës së studentëve gjatë gjithë rrugëtimit të tyre. Pjesëmarrja në këtë panair synon përfshirjen dhe edukimin e brezave të rinj në sektorin e sigurimeve dhe investimeve.

Falë këtij aktiviteti, studentët u njohën më nga afër me mundësitë e praktikave profesionale dhe të punësimit që Albsig Invest ofron në departamente të ndryshme.

3.3. Albsig Invest mbështet Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" me rastin e festës së 1 Qershorit.

Këtë 1 Qershor, Albsig Invest zgjodhi të ishte pranë fëmijëve të shtëpisë së fëmijës "Zyber Hallulli" me dhurata dhe veshje për t'u ardhur sadopak në ndihmë në këtë ditë të veçantë dhe të gëzuar për ta. Albsig Invest mbështet shtëpinë e fëmijës "Zyber Hallulli" në Tiranë, duke bërë të mundur që çdo fëmije nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të, në këtë institucion, të mos i mungojnë veshjet verore dhe çdo material tjetër i domosdoshëm për të kaluar sezonin veror.

Gjithashtu, përveç materialeve të domosdoshme, veshje e materiale sportive, etj. Albsig Invest e sheh këtë dhurim si përmbushje të përgjegjësive dhe detyrimevetë tij të përgjegjësive sociale.

Albsig Invest, pjesë e Kastrati Group, ka qenë dhe është gjithmonë e hapur ndaj kauzës së fëmijëve jetimë, me dëshirë për të mësuar dhe për të zhvilluar edhe më tej aftësitë personale dhe profesionale, duke u dhënë hapësirën e kërkuar për të përfituar sadopak eksperiencë dhe mundësi.



3.4. Apeli i Stafit të Albsig Invest në Ditën Botërore të Dhurimit të Gjakut "Të gjithë Ne, me aq sa kemi mundësi, të dhurojmë gjak të paktën një herë në vit, sepse me çdo dhurim tonin, Ne shpëtojmë jetë"

Çdo vit më 14 Qershor në shumë vende të botës organizohet "Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut" dhe kësaj dite i është bashkuar dhe stafi i Albsig Invest. Mesazhi i kësaj dite thekson kontributin thelbësor që dhuruesit e gjakut japin për të mbajtur botën pulsuese, duke shpëtuar jetë dhe duke përmirësuar shëndetin e të tjerëve.

Një fokus i veçantë i fushatës së këtij viti do të jetë roli i të rinjve në sigurimin e një furnizimi të sigurt me gjak. Si në shumë institucione edhe në Albsig Invest, të rinjtë kanë qenë në ballë të aktiviteteve dhe iniciativave që synojnë arritjen e furnizimeve të sigurta të gjakut përmes dhurimeve të gjakut në mënyrë vullnetare. I gjithë stafi i Albsig Invest iu bashkua nismës për dhurimin e gjakut. Kjo nismë u cilësua si një ndër nismat më të rëndësishme e cila është në mënyrë të drejtpërdrejtë në ndihmë të çdo jete. Stafi i Albsig Invest ishte i gatshëm të jepte kontributin e tij në ndihmë të kauzës "Dhuro gjak, dhuro jetë". Çdo punonjës në mënyrë vullnetare, pasi mori dakortësinë nga ekipi i mjekëve, bëri të mundur dhënien e kontributit të vlefshëm për shpëtimin e një jete, siç ishte dhurimi vullnetar i gjakut.



Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut shënohet prej vitit 2004 dhe ka për qëllim dhurimin e gjakut për të shpëtuar jetën e atyre në nevojë. Aktivitetet për këtë ditë bëhen me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimin e gjakut dhe për të shprehur falenderime për të gjithë ata që dhurojnë gjak për të shpëtuar jetë. Gjaku, përveçse një përbërës i rëndësishëm i trupit tonë, është edhe një lëndë kuruese që nuk mund të prodhohet nga industria farmaceutike, ndaj i vetmi burim i tij është dhurimi nga njerëzit me vullnet të mirë në mënyrë të herëpashershme dhe pa pagesë.

Nevojat për gjak janë shumë të mëdha, pasi transfuzioni i gjakut apo përbërësve të tij shërben shpesh për t'i shpëtuar jetën dikujt që pëson aksident apo ndërhyrje kirurgjikale. Fushata e këtij viti përqendrohet tek ata pacientë, të cilëve do u duhen transfuzione gjaku përgjatë gjithë jetës. Autoritetet shëndetësore theksojnë rëndësinë e dhurimit të gjakut në mënyrë të rregullt për të krijuar një rezervë të vazhdueshme gjaku, në mënyrë që pacientët në nevojë të mund ta marrin atëherë kur do të kenë nevojë.

Nevojat për gjak në stinën e verës rriten, për këtë arsye apeli i të gjitha institucioneve shëndetësore është për më shumë dhurime vullnetare në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe të gjithë atyre që kanë nevojë për gjak. 14 Qershori njihet si Dita Botërore e Dhurimit Vullnetar të Gjakut. Slogani i këtij viti është:

"Dhuro gjak, dhuro jetë, dhuro plazmë, dhuro shpesh".

4. ECURIA E BORXHIT QEVERTAR DHE E NORMAVE TË INTERESIT GJATË VITIT 2023.

Gjatë vitit 2023 Banka e Shqipërisë ka rritur normën bazë në mbledhjen e mujit mars 2023 nga 2.75% në 3% dhe në mbledhjen e muajit nëntor nga 3 në 3.25%.

Pavarësisht rritjes së normës bazë yield-et e bonove dhe obligacioneve janë ulur përgjatë tremujorit të parë dhe të dytë dhe janë stabilizuar gjatë tremujorit të tretë. Yield-et përgjatë tremujorit të katërt janë rritur por përgjatë gjithë vitit vërehet një ulje e normave në krahasim me vlerat e vitit 2022, përafërsisht me 2% përgjatë gjithë kurbës së yield-eve.

Bono 12 mujore është ulur nga 5.47% në fillim të vitit në 3.36% në fund të vitit. Obligacioni 2 vjeçar është ulur nga 6.24% në 4.23%, obligacionet referencë 3 dhe 5 vjeçare janë ulur nga 5.8% dhe 6.84% në 4.89% dhe 5.58% respektivisht. Obligacionet 7 vjeçare nga 7.98% në 5.96%, obligacionet 10 vjeçare nga 7.48% në 6.44%. Obligacioni 15 vjeçar është ulur nga 8.95% në 7.89%. Për ta përmbledhur, mesatarisht vërehet një ulje afërsisht prej 2% të normave të titujve gjatë vitit 2023.

4.1. Menaxhimi dhe politikat e investimit

Pas efektit negativ që rritja e normave të interesit dha për fondet e investimit gjat vitit 2022 vitin, momenti më i favorshëm për investitorët e rinj ishte padyshim viti 2023.

Normat e interesit të bonove dhe obligacioneve arritën kulmin në fund të vitit 2022. Rritja e shpejtë e normave të interesit gjatë vitit 2022 ishte një fenomen global, që shkaktoi ndër performancat më të ulëta historike të fondeve që investojnë në bono dhe obligacione.

Albsig Invest ndoqi me kujdes politikën monetare dhe u pozicionua në mënyrë të favorshme gjatë vitit 2023 duke sjellë një normë kthimi pozitive prej 8.02%, me rritje të Vlerës Neto të Aseteve (NAV) me rreth 20%. Normat e interesit nga leximet e politikës monetare arritën kulmin dhe Albsig Invest mori masa për fondin e investimit dhe për fondet e pensionit për të përfutur sa më shumë.

4.2. Ligji i ri për fondet private të pensioneve dhe efektet që priten të japë në zhvillimin e tregut të pensioneve private.

Ligji për “Për fondet e pensionit privat”, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, hyri në fuqi më 6 nëntor 2023. Ky ligj, përmirëson shumë aspekte, të cilat ligji në fuqi nuk i trajton, ose i trajton jo në mënyrën e duhur. Projektligji është një përafrim i mirë i Direktivave Europiane që rregullojnë fondet e pensionit.

Në lidhje me përmirësimet që pritet të kenë ndikim do të veçoja trajtimin fiskal, i cili ka një përmirësim të dukshëm dhe pak shtete e kanë në këtë formë që është propozuar në Shqipëri.

Për ta ilustruar, në ligjin aktual, kontributi përjashtohet nga tatimi në momentin e derdhjes, interesi i fituar gjatë fazës së akumulimit gjithashtu përjashtohet, por pagesa e pensionit që merrte kur del në pension tatóhet mbi të gjithë shumën e tërhequr.

Ndërsa ligji i ri përjashton kontributin nga tatimi në momentin e derdhjes. Interesi i fituar gjatë fazës së akumulimit gjithashtu përjashtohet dhe risia është që kontributet e bëra nuk do të tatóhen as në



momentin e tërheqjes, nëse bëhen në formën e pensionit (këste mujore) për një periudhë më të madhe se dy vjet.

Në këtë rast do të tatohet vetëm interesi i akumuluar gjatë periudhës. Kjo lehtësi, por edhe të tjera që janë parashikuar në ligjin e ri, mendojmë se do të nxisë anëtarët aktualë dhe ata potencialë për të marrë pjesë në fonde pensioni.

Mbrojtja e interesave të anëtarëve të fondit të pensionit privat, si edhe nxitja e pjesëmarrjes në skemën e pensionit privat, janë ndër synimet kryesore të këtij ligji.

Ligji sjell për herë të parë edhe një formë të re të fondit privat të pensionit, atij me pjesëmarrje të mbyllur. Fondi i këtij lloji mund të krijohet nga një punëdhënës, disa punëdhënës, ose një entitet i organizuar si bashkim punëdhënësish, sindikatë, bashkime sindikatash apo shoqatë, në cilësinë e sponsorit.

Gjithashtu ligji i ri parashikon edhe rregullime që lidhen me marketingun dhe veprimtarinë promovuese të fondit të pensionit privat, duke i bërë këto fonde më shumë të njohura për individët dhe punëdhënësit që duan të kontribuojnë për punëmarrësit e tyre.

Për më tepër ligji, gjithashtu, krijon kushte për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare si një ndër kërkesat e Direktivës IORP II, kur Shqipëria të bëhet vend anëtar i Bashkimit Evropian.

Megjithatë, duhet që jo vetëm Shoqëritë Administruese, por institucionet shtetërore si AMF, ISSH apo Ministria e Financave dhe Ekonomisë të shfaqin dhe reklamojnë mundësinë që krijohet nga ligji i propozuar, për pjesëmarrjen në fonde pensioni.

Kjo mundësi, në periudha afatmesme, do të jetë mbështetëse e fortë e skemës shtetërore të pensionit.

4.3. Tregu i pensioneve private vullnetare vijoi rritjen edhe gjatë vitit 2023.

Tregu i pensioneve private vullnetare vijoi rritjen edhe gjatë vitit 2023.

Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) tregojnë se numri total i anëtarëve arriti në 38 180, në rritje me 4.55% krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2023, fondeve private të pensioneve u janë shtuar 1662 kontribuues, ndërkohë që 419 anëtarë prej tyre kanë zgjedhur fondet e pensionit privat Albsig dhe Smart Pension.

Vlera e aseteve neto të fondeve të pensionit Albsig dhe Smart Pension në fund të muajit dhjetor 2023 arriti në 512 milion lekë, në rritje me 39% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Me gjithë rritjen e qëndrueshme të viteve të fundit, depërtimi i pensioneve private dhe vlera e aseteve për çdo anëtar ngelen modeste. Me pak se 3% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve sot kontribuojnë për një pension privat në pleqëri. Edhe për nga vlera e aseteve, tregu i fondeve private ngelet ende segmenti më i vogël i tregut financiar në Shqipëri.

Rritja modeste e tregut, duke pasur parasysh edhe nivelin mjaft të ulët të depërtimit të pensioneve private në shoqëri, tregon se zgjerimi i këtyre skemave mund të ketë nevojë për më shumë incentive. Në nëntor të vitit të kaluar, hyri në fuqi ligji i ri “Për fondet e pensionit privat”, që do të sjellë rritje të ndjeshme të incentivave fiskale për kontributet në fondet private të pensioneve.

Ligji i ri “Për fondet e pensionit privat”, që hyri në fuqi këtë muaj, synon të rrisë incentivat për të rritur investimet në fondet private të pensioneve. Ligji parashikon rritjen e përjashtimit nga taksat si për kontributet e punëmarrësve, ashtu edhe për ato të punëdhënësve.

Me ligjin e ri, kufiri maksimal mujor i përjashtimit tatimor do të rritej deri në nivelin e pagës minimale të miratuar, që aktualisht ka arritur në 40 mijë lekë në muaj. Ligji i ri gjithashtu parashikon që pensionet të mos taten në përfitim për pjesën e kontributeve, por vetëm për kthimin nga investimi, me kusht që tërheqja të bëhet me pagesa mujore të shtrira në të paktën dy vite dhe jo në mënyrë të menjëhershme pas përmbushjes së kushteve ligjore për përfitimin e pensionit privat.

Ndërkohë, në disa deklarime publike të muajve të fundit, përfaqësues politikë të qeverisë shqiptare janë shprehur se tashmë po merret në konsideratë një reformë e re e pensioneve, që mund të përfshijë fondet private si kolonë e dytë, e detyrueshme, e skemës.

Në ndarjen e tregut sipas vlerës së aseteve, rritje kanë shënuar dy fondet e administruara nga Albsig Invest, Albsig Pension dhe Smart Pension, ndërsa fondet e tjera të investimit kanë pësuar rënie të peshës së tyre të tregut.

4.4. Risitë e pritshme në tregun e fondeve të pensioneve për periudhën në vazhdim.

Në vitin 2023, Shoqëria Administruese Albsig Invest hapi një fond të dytë pensioni, Fondin e Pensionit Privat Smart Pension, me bankë depozitare Bankën Kombëtare Tregtare (BKT).

Në këtë mënyrë, Albsig Invest solli, edhe një herë, një risi në treg duke u bërë Shoqëria Administruese e parë që do të administrojë dy fonde pensioni në të njëjtën kohë me banka depozitare të ndryshme.

Fondi i Pensionit Smart Pension filloi aktivitetin, duke anëtarësuar klientët e parë, në fillim të vitit 2023. Risia që ky fond sjell në treg është përdorimi i kanaleve dixhitale të BKT, në funksion të marketimit të fondit për të cilën Banka është miratuar, për të kërkuar anëtarësimin në Fondin e Pensionit Smart Pension.

Me zhvillimet e mëtejshme të teknologjisë dhe pranimin të lidhjes dhe nënshkrimit të kontratave të pensionit në distancë, ky fond do të sjellë risi të tjera.

Hapja e Fondit të Pensionit Smart Pension na bën entuziast, duke qenë se u drejtohet kryesisht moshave të reja që janë përdorues të rregullt të aplikacioneve smart.

Telefonat dhe aplikacionet smart tashmë janë gjithmonë bashkë me individin dhe aksesimi i më shumë shërbimeve kryhet nëpërmjet tyre.

Gjithashtu, me miratimin e projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, presim krijimin e fondeve të mbyllura të pensionit, që është një nga risitë e tjera që sjell ky ligj, që mund të jenë organizime të disa kompanive brenda një industrie të caktuar apo nën një bashkim punonjësish.



Fondet e mbyllura japin mundësi që kompanitë që bëjnë pjesë në këtë fond të posaçëm të vendosin së bashku me Shoqërinë Administruese mbi politikën e investimit dhe koston e administrimit të fondit.

4.5. Pritshmëritë për vitin 2024

Në muajt e parë të vitit 2024, Shoqëria Administruese ka informuar investitorët aktualë dhe potencialë të Fondit të Investimit Albsig Standard që, në varësi të horizontit të tyre të investimit, tani është një moment shumë i favorshëm për të investuar në kushtet kur normat e interesit të bonove dhe obligacioneve mund të kenë arritur kulmin dhe do të vijoje rënia e tyre.

Pritshmëritë për tremujorin e parë apo të dytë të vitit 2024 do varen nga uljet ciklike që zakonisht përsojnë normat gjatë kësaj periudhe dhe nga vendimet e politikës monetare nëse Bank e Shqipërisë do rrisi normën bazë pasi inflacioni në muajt e fundit nuk është ulur sa dëshirohej. Megjithatë Banka e Shqipërisë është shprehur se tashmë është realizuar normalizimi i politikës monetare dhe nëse do kemi rritje të normës ato do jenë të vogla. Sipas Bankës së Shqipërisë inflacioni pritet të ulët drejt target-it (3%) brenda gjysmë së dytë të vit. Inflacioni ka rezultuar në 3.9% gjatë dy muajve të parë të tremujorit të katërt dhe po tregon shenja persistence. Mbetet për tu monitoruar nga afër ecuria e inflacionit pasi ndikon mbi vendimin e politikë monetare pasi rezultoj 4% në dhjetor 2023.

5. ECURIA E FONDIT TË INVESTIMIT “ALBSIG STANDARD”

Fondi Investimit Albsig Standard është një Sipërmarrje Investimesh Kolektive (SIK), e veçantë me pjesëmarrje të hapur e cila administrohet nga shoqëria administruese “Albsig Invest sh.a.”



5.1. Objektivat dhe politika e investimit

Albsig Standard investon kryesisht në obligacione dhe bono të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të emetuara në Lekë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat tregtare në Shqipëri. Objektivi i investimit është rritje e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. Fondi për të arritur diversifikimin mund të investojë deri në 10% në tituj borxhi të transferueshëm të kompanive apo njërive vendore me seli në Republikën e Shqipërisë por këto investime nuk ndikojnë mbi tolerancën e ulët për rrezik që ka Fondi.

Investitori mund të shlyej të gjithë kuotat apo një pjesë të tyre sipas kërkesës në çdo kohë mbas investimit fillestar pa prishur normën e kthimit të realizuar deri në atë periudhë.

Fondi i Investimit Albsig Standard nuk mbështet në një tregues referencë (benchmark) të caktuar. Të ardhurat nga Fondi ri-investohen dhe nuk shpërndahen. Kostot e transaksioneve të portofolit nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit. Rekomandohet që afati për investimin në Fond të jetë të paktën 2 vjet.

Performanca e fondit ndikohet kryesisht nga ecuria e normave të interesit të letrave të borxhit të Republikës së Shqipërisë. Fondi investon vetëm në klasat e asetëve të përmendura më sipër dhe nuk lejon zgjedhje të lira në lidhje me investime të veçanta të lejueshme.

5.1.1. Profili i riskut dhe përfitimit

Risk i ulët					Risk i lartë	
Përfitime zakonisht të ulëta					Përfitime zakonisht të larta	
1	2	3	4	5	6	7

Fondi i Investimit Albsig Standard ka një indikator risku në nivelin 2, pra të ulët, por nuk do të thotë që investimi është pa rrezik. Kategoria 2 përbën një risk sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator risku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator risku më të ulët. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nëpërmjet një rregullore specifike përcakton lidhjen midis luhatshmërisë së fondit dhe indikatorit të riskut sintetik. Për shkak se kjo kategori sintetike përdor të dhënat historike, treguesi sintetik mund të ndryshojë në të ardhmen por ky ndryshim parashikohet të jetë i rrallë. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik mund të mos jenë të dhëna relevante për profilin e ardhshëm të riskut të Fondit të Investimit Albsig Standard.

Risqet që nuk janë të përmbledhura në kategorinë e riskut sintetike janë: risku i kreditit, risku likuiditetit, risku operacional, risku i palës tjetër. Risku i kreditit mund të ndodh kur emetuesi i ndonjë obligacioni apo bono nuk është i gatshëm të paguaj interesin apo principalin në kohë.

Obligacionet dhe bonot zotërojnë një spektër gradash që përfaqësojnë riskun e kredisë. Fondi do investoi kryesisht në letra borxhi të Republikës së Shqipërisë dhe është lidhur ngushtë me aftësitë paguese të



Shtetit Shqiptar. Risku i likuiditetit lidhet me faktin se obligacionet dhe bonot e Republikës së Shqipërisë nuk mund të tregtohen në çdo kohë apo do tregtohen me çmime jo të favorshme. Risku Operacional lind nga gabime të sistemeve ose gabime njerëzore të shoqërisë administruese. Risku i palës tjetër ndodh kur një pagesë të mos kryhet apo të kryhet me vonesë në një sistem transfertash për shkak të moszbatimit të kushteve të paracaktuara.

5.1.2. Komisionet/tarifat e Fondit

Komisionet/tarifat që investitori paguan përdoren për të shlyer kostot e administrimit të Fondit të Investimit Albsig Standard. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit. Komisionet dhe tarifatat mund të jenë subjekt ndryshimi.

- Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit
- Komisioni/tarifa e hyrjes - 0 %
- Komisioni/tarifa i/e shlyerje - 0 %
- Komisionet/tarifatat të vazhdueshme që mbahen nga Fondi gjatë periudhës së një viti
- Komisioni/tarifa vjetore e administrimit të Fondit – deri në 1%

5.1.3. Komisione dhe tarifa të tjera të vazhdueshme

- Tarifa e auditimit vjetor të fondit është sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.
- Tarifa e depozitarit - 0.17% në vit e VNA
- Tarifa e AMF - 0.05% në vit e vlerës së përgjithshme të aseteve
- Tarifa e kostos së vazhdueshme, në një vit financiar nuk do të tejkalojnë maksimumin prej 1.5% (një pikë pesë përqind) të vlerës neto të aseteve të Fondit.


5.1.4. Komisionet/tarifatat të tjera të mbajtura nga Fondi

- Kosto të transaksioneve për investimin e aseteve të fondit - sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.
- Kostot e transaksioneve nuk do të përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por i mbahen Fondit.

Për më shumë informacion për komisionet, ju lutemi shihni faqet përkatëse të prospektit të Fondit, të cilin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit eëë.albsiginvest.al


Portofoli i Fondit të Investimeve Albsig Standard më 31 dhjetor 2023, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Shpërndarja e Instrumentave sipas llojit më 31 Dhjetor 2023 (%NAV)



5.1.5. Norma Neto e Kthimit për “Albsig Standard” 2021-2023

Norma Neto e Kthimit për “Albsig Standard” 2021-2023



	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2023
■ Norma Neto e Kthimit për “Albsig Standard” 2021-2023	4.44	-7.11	8.02

Fondi i Investimit Albsig Standard për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 ka rezultuar me një normë kthimi prej 8.02%. Tarifa e administrimit zbritet përpara llogaritjes së normës së kthimit. Performanca e mëparshme apo performanca afatshkurtër nuk duhet përdorur si udhëzuese e performancës në të ardhmen.



6. ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT ALBSIG

Fondi i adresohet klientëve konservator me tolerancë të ulët rreziku. Fondi investon vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aset me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve.

6.1. Politika e Investimit

Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjata të Shtetit Shqiptar. Element i rëndësishëm që shoqëron investimin për pension është kohëzgjatja e gjatë.

6.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit:

- Objektivi:** Optimizimi i normës së kthimit duke ruajtur principalin;
- Toleranca për Rrezik:** E ulët;
- Horizonti i Investimit:** Afatgjatë (10-30 vjet);
- Likuiditeti:** I ulët.
- Strategjia e Investimit:** Fondi do të ndjekë një strategji të investimit në asete afatgjata. Fondi gjithashtu ka kërkesa të ulta për likuiditet duke konsideruar kohëzgjatjen e qëndrimit të gjatë në fond dhe prurjet periodike nga pagesat automatike të skemave profesionale dhe individuale.

6.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit

Risk i ulët				Risk i lartë		
Përfitime zakonisht të ulëta				Përfitime zakonisht të larta		
1	2	3	4	5	6	7
1	2	3	4	5	6	7


6.1.3. Komisionet/tarifat e Fondit

Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifat e mëposhtme:

Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 2.5% (dy pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit;


Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar. Portofoli i Fondit të Pensioneve Privat Albsig më 31 dhjetor 2023, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Shpërndarja e Instrumentave sipas llojit më 31 Dhjetor 2023 (%NAV)



6.1.4. Norma Neto e Kthimit për “Alsig Pension” 2021-2023

Norma Neto e Kthimit për “Alsig Pension” 2021-2023



	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2023
Norma Neto e Kthimit për “Alsig Pension” 2021-2023	2.22	2.74	3.81

7. ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT SMART PENSION

Fondi i adresohet klientëve konservator me tolerancë të ulët rreziku. Fondi investon vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aset me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve.

7.1. Politika e Investimit

Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjata të Shtetit Shqiptar. Element i rëndësishëm që shoqëron investimin për pension është kohëzgjatja e gjatë.

7.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit:

- Objektivi:** Optimizimi i normës së kthimit duke ruajtur principalin;
- Toleranca për Rrezik:** E ulët;
- Horizonti i Investimit:** Afatgjatë (10-30 vjet);
- Likuiditeti:** I ulët.
- Strategjia e Investimit:** Fondi do të ndjekë një strategji të investimit në asete afatgjata. Fondi gjithashtu ka kërkesa të ulta për likuiditet duke konsideruar kohëzgjatjen e qëndrimit të gjatë në fond dhe prurjet periodike nga pagesat automatike të skemave profesionale dhe individuale.

7.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit

Risk i ulët				Risk i lartë		
Përfitime zakonisht të ulëta				Përfitime zakonisht të larta		
1	2	3	4	5	6	7


7.1.3. Komisionet/tarifat e Fondit

Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifat e mëposhtme:

Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 1.5% (një pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit;

Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar. Portofoli i Fondit të Pensioneve Privat "Smart Pension" më 31 dhjetor 2023, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.


Shpërndarja e Instrumentave sipas llojit më 31 Dhjetor 2023 (%NAV)



	Obligacione	Mjete Monetare dhe Ekuivalente
■ %NAV	99.06	0.94

7.1.4. Norma Neto e Kthimit për “Smart Pension” deri më

Norma Neto e Kthimit për “Smart Pension” 2023



	14.01.2024	31.12.2023
■ Norma Neto e Kthimit për “Smart Pension” 2023	4.69	0

***Shënim:** Duke qenë se Fondi i Pensionit “Smart Pension” bën një vit më 14.01.2024, nuk përlogaritet kthimi vjetor më 31.12.2023.

8. PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR



Për Drejtimin e Shoqërisë Albsig Invest sha.

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Albsig Invest sha. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

